



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1024 Prot.

Tiranë, më 11/05/2020

VENDIM
Nr. 40, Datë 11.05.2020

**“PËR PUBLIKIMIN E KËRKESË PËR APLIKIM PËR ANËTARË NË KOMISIONIN E
APELIMIT NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 39, Pika 1, 2 e vijues të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores ...”, dhe sipas rendit të ditës Senati Akademik pasi mori në shqyrtim dhe diskutoi materialin,

VENDOSI:

1. Të publikojë kërkesën për aplikim për anëtarë në Komisionin e Apelit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë sipas Formularit për Aplikim bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të drejtën për të aplikuar e kanë individët që:
 - a. Kanë pervojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 (pesë) vjet, me kohe të plotë;
 - b. Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
 - c. Nuk kanë lidhje gjinore në vijë të drejtë ose të tërthortë, deri në shkallë të katërt, me kandidatë që konkurrojnë në zgjedhje.
3. Afati i dorëzimit të dokumenteve për aplikim si anëtarë i Komisionit të Apelit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, do të jetë nga data **11.05.2020** deri më **15.05.2020**.
4. Dokumentacioni përkatës do të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit në Rektoratin e UMT-së në intervallin kohor **09:00** deri në orën **16:00**.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETARI
ARBEN GJATA**

